

AKTI I THEMELIMIT

I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA

«Container Full Service Albania» Sh.P.K.

Neni 1 Emertimi i Shoqerise

Sot në Tiranë në datën 08 Dhjetor 2020 me vullnetin e lirë Ortakët e Shoqërise:

Shoqëria “STARGATE” Sh.p.k. me NIPT L72218034K me seli në Bulevardin “Zogu i Parë”, Qendra Tregtare Tirana, Godine Shumekateshe banimi dhe sherbimi, kati i peste, Tiranë, dhe

Shoqëria “ALBANIAN STEVEDORING COMPANY (ASC)” Sh.p.k. me NIPT K92128501U dhe me seli në Lagjja 1, Rruga Tregtare, Porti Detar, Pranë Zonës së Mirëmbajtjes Mekanike, Durrës,

Vendosën: të themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar emërtimi i së cilës do të jetë «Container Full Service Albania» Sh.p.k.

Neni 2 Selia e Shoqerise

Shoqëria do ta ketë seline e saj në qytetin e DURRESIT, Lagjja 1, Rruga Tregtare, Porti Detar, Pranë Zonës së Mirëmbajtjes Mekanike, por me Vendimin e Asamblese së Ortakeve, mund të ngrihen edhe dege, filiale apo dhe seli në vende të tjera, brenda dhe jashtë territorit të Shtetit Shqiptar.

Neni 3 Kohezgjatja e Veprimtarise

Kohezgjatja e veprimtarise do të jetë 10 vjet të njepasnjeshem, por me Vendim të Asamblese së Ortakeve, ky afat mund të ripërterihet.

Neni 4 Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërise përbehet nga 100.000 (njqindmije leke), i ndarë në 2 kuota, i cili është teresisht kapital financiar e përbehet nga kontributi i ortakeve si më poshte:

Shoqëria “STARGATE” Sh.p.k., zoteron një kuote e njësuar me 51% të kapitalit, me vlerë nominale të barabarte me 51.000 Leke (pesëdhjetë e një mijë lekë).

Shoqëria “ALBANIAN STEVEDORING COMPANY (ASC)” Sh.p.k., zoteron nje kuote e njesuar me 49% te kapitalit, me vlere nominale te barabarte me 49.000 Leke (dyzetë e nëntë mijë lekë).

Ortakët kanë të drejtë ta tjetërsojnë këto kapital, të shtojnë apo të pakesojnë kuotat e kapitalit deri në kufijtë e përcaktuara nga ligji.

Neni 5 Objekti i Veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së kësaj Shoqërie do të jetë:

- Mirembajtja e kontenierëve të transportit të të gjitha llojeve, pastrimin dhe riparimet mekanike, elektrike e frigoriferike. Mirembajtje të mjeteve lundruese duke përfshirë riparimin dhe pastrimin e tyre. Ngarkim, shkarkim të mjeteve lundruese dhe aktiviteteve të ngjashme siç janë depozitimi, magazinimi, grupimi, marrja dhe dorëzimi i ngarkesave etj.
- Aktivitet në fushën e tregtisë: Shitje blerje kontenierësh, Import - Eksport si dhe tregti me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm të lejuar nga ligji, mallrave ushqimore dhe industrial, të materialeve të ndërtimit, hidrosanitare, hidraulike, makinave dhe automjeteve të tonazheve të ndryshme, pllakave të të gjitha llojeve, plastikes, gomes, lendeve drusore dhe mobiljeve, linjave të prodhimit dhe përpunimit, makinerive të llojeve dhe tonazheve të ndryshme, por pa u kufizuar vetëm në këto, por edhe mallrave tregtimi i të cilave kërkon license të vecante si dhe importimin e lendeve të pare për prodhim. Shitblerje të artikujve joushqimore, detergjente, materiale pastrimi, etj. Zhvillimi dhe ndërtimi në sektorin e energjisë, projektim, ndërtim, financim, shfrytëzim i veprave të ndryshme në fushën e prodhimit të energjisë elektrike nëpërmjet veprave të ndryshme si HEC, 2 impianteve fotovoltaike, turbinave eolike etj, dhe të çdo lloji ndërtimi në sektorin e energjetikës.
- Aktivitet në fushën e marketingut: Funksione të agjencit të shitjes për shoqëri vendase dhe të huaja, duke hapur dege apo zyra në vende të huaja për arritjen e objektivave të shoqërisë, duke kryer të gjitha veprimet që lidhen me këto veprimtari.
- Aktivitet në fushën e shërbimeve: Hapje agjensish turistike, spedicioni, detare, transporti, shitje për shoqëri vendase dhe të huaja etj.
- Hapja e Bar- Restoranteve, Picerive e aktiviteteve në fushën e Hoteleri-Turizem.
- Transport për vete dhe të tjerë, nacional e internacional.

Me zgjerimin e aktiviteteve, shoqëria mund të bëjë shtesa të ndryshme ose ndryshime të objektit të veprimtarisë së saj, duke bërë ndryshimet përkatëse në Status.

Neni 6

Kalimi i kuotave me trashëgimi (Mortis Causa) ose për shkak të Falimentimit të Ortakut

Në rast vdekje apo falimenti të njërit prej ortakëve, kalimi i kuotës dhe i të drejtave përkatëse në favor të trashëgimtarëve apo personave që fitojnë këto të drejta duhet të

miratohet nga Asambleja e Përgjithshme, e cila duhet të shprehet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi i vdekjes apo i falimentit të ortakut. Në rast të refuzimit të pëlqimit apo nëse Asambleja e Përgjithshme nuk është shprehur brenda afatit të sipërpërmendur, Shoqëria do t'ju paguajë trashëgimtarëve apo personave që fitojnë këto të drejta vlerën e kuotës që do të përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme, duke patur parasysh gjendjen pasurore të Shoqërisë dhe vlerën e tregut të kuotës.

Personi që fiton të drejtën mbi kuotën e pjesëmarrjes për shkak të vdekjes apo falimentimit të një ortakut mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të zgjedhur prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton Shoqërinë në lidhje me këtë vendim.

Personi që fiton të drejtat mbi një kuotë për shkak të vdekjes apo falimentimit të një ortakut do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit si zotërues i kuotës.

Neni 7 Zmadhimi i Kapitalit

Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakëve që janë thirrur, nëse nuk janë të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që vendosi zmadhimin e kapitalit.

Në rasta zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit në para ose me kontribute në natyrë, në përpjesëtim të drejtë me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të pjesës së tyre, kapitali i panënshkruar prej tyre mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë sërish të drejtën për nënshkrimin e kapitalit, në përpjesëtim të drejtë me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

Neni 8 Zvogëlimi i Kapitalit

Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.

Ortakët e përballojnë zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë, në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 9 Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në



fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akti Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë.

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri.

Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një person tjetër, me prokurë me shkrim.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike (conference call) audio ose video, në përputhje me ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe ligjin për Komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali përkatës.

Asambleja e përgjithshme mund të thirret nga Administratorët ose nga ortakët në bazë të nenit 84 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe Shoqëritë Tregtare". Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e njoftuara Shoqërisë të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.

Asambleja e përgjithshme do të mbledhet rregullisht pavarësisht nga këto formalitete, kur ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord të vendosin në lidhje me rendin e ditës.

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratorët. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje ndër personat e pranishëm.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.

Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar. Asambleja e Përgjithshme, përveçse për sa parashikon neni 9 i këtij akti themelimi dhe Statuti, për vendime që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë, sipas nenit 86 pika 1 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë Tregtare".

Neni 10

Organet Drejtuese te Shoqerise

Organet e Shoqerise jane:

1 – *Asambleja e ortakeve* e cila perbehet prej dy ortakeve themelues.

2- *Administratori* i deleguar i shoqerise qe do te jete Znj. Brisilda Tila, me shtetesi shqiptare, me nr. Personal I15128138A, me atësi Behxhet, datëlindje 28.01.1981, lindur në Durrës, Shqipëri dhe me banim në Tiranë, e cila do te perfaqesoje shoqerine "Container Full Service Albania" sh.p.k. ne marredhenie me te tretet per nje afat pesë vjeçar.

Neni 11
Shperberja dhe likuidimi

Shoqeria shperbehet per arsyet e parashikuara nga ligji dhe me :

- a. Per mbarimin e afatit
- b. Per pamundesi te funksionimit ose per inaktivitetit te vazhduar te asamblese
- c. Per reduktimin e kapitalit nen minimumin ligjore,
- d. Me vendim te asamblese dhe per arsye te tjera te parashikuara me ligj

Ne te gjitha hipotezat e shperberjes, asambleja e ortakeve, do te caktoje nje ose me shume likuidatore duke percaktuar numrin e likujdvesve si dhe kriteret ne baze te te cilave do kryhet likuidimi.

Neni 12

E gjithë veprimtaria e shoqërisë do të bazohet në Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” si dhe ligji nr 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendren Kombëtare të Rregjistrimit” si dhe në Legjislacionin në përgjithësi të Republikës së Shqipërisë.

Neni 13

Ky Akt Themelimi u nënshkrua në pesë kopje të barazvlefshme të tij sot me datën 8 Dhjetor 2020 (tetë dhjetor të vitit dy mijë e njëzetë) .

Asambleja e Ortakeve:

“STARGATE” Sh.p.k

Bilbil Laci



“ALBANIAN STEVEDORING COMPANY (ASC)” Sh.p.k

Ime Shkurt

